



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE

EC MA NDRYSHE RAPORT I PUNËS 2021

Rr. Fehmi Lladrovci 94, 20000/Prizren ~ Bulevardi Nënë Tereza H30 B1 Nr. 5, 10000/Prishtinë
www.ecmandryshe.org ~ info@ecmandryshe.org ~ 038-224-967 & 029-222-771

QASJE E RE STRATEGJIKE DHE PROGRAMET

Plani Strategjik i EC-it është i ndërtuar mbi tri qëllime strategjike të cilat brenda vetes kanë objektiva strategjike që përshkruajnë në detaje më të mëdha se si EC do të përmbushë dhe do të arrijë misionin dhe vizionin e tij, respektivisht:

- Komunitete lokale të mirëorganizuara dhe presioni i rritur publik nxisin praktika të përparuara të qeverisjes demokratike dhe gjithëpërfshirëse në komunat e Kosovës,
- Dimensionet mjedisore dhe sociale të integruara në programe dhe politika që synojnë zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm lokal dhe rajonal,
- Vëllim i rritur i dijes sektoriale për të ushqyer debatin shoqëror dhe politikëbërjen, si dhe një organizatë me shkathtësi të konsoliduara programore dhe qëndrueshmëri institucionale.

EC mbetet çfarë ka qenë që nga fillimi, organizatë me bazë në komunitet. Temat dhe çështjet mund të ndryshojnë, por çfarë mbetet konstante është metodologjia. EC beson në nevojën dhe domosdoshmërinë e organizimit komunitar si garancinë më të madhe të demokratizimit dhe zhvillimit.

Duke filluar nga muaji Shkurti i vitit 2020, EC funksionon me këto tri programe:

Gjithëpërfshirje (Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse)

Qëndrueshmëri (Zhvillim i Qëndrueshëm)

Dije (prodhim i dijes)

Shtrirja gjeografike

Prej vitit 2015 EC përveq qytetit të Prizrenit dhe Prishtinës është shtrirë në shumicën e komunave të Kosovës duke bërë implementuar projekte dhe aktivitete të ndryshme që kanë për qëllim avokimin dhe shtimin e presionit publik për përmirësimin e kushteve jetësore. Si pjesë e avokimit për mbrojtjen e qendrave historike të Kosovës, përveq QH Prizren, EC që nga fillimi i vitit 2015 po i vëzhgon edhe qendrat historike të Gjakovës, Prishtinës, Pejës dhe Mitrovicës.

PROJEKTET

Gjatë vitit 2021 është punuar në shtatë projekte. Projektet e organizatës gjatë vitit 2021 për shkak të pandemisë COVID-19 kanë patur shtrirje gjeografike më të kufizuara, ku përfshihen komunat si: Prizreni, Prishtina, Lipjani, Istogu, Peja, Mamusha, Ferizaji, Graçanica, Suhareka, Dragashi, Rahoveci dhe Gjakova.

Qytetet Gjithëpërfshirëse 2021

Viti 2021, me projektin “Qytetet Gjithëpërfshirëse” ka qenë vazhdimësi e metodologjisë së re të projektit, ku nga puna me grupet e komunitetit (me bazë identitare) u kalua në organizimin e njërive komunitare në nivel të lagjeve të qytetit dhe në disa fshatra si dhe në disa qytete tjera. Gjatë vitit 2021 projekti ka nxitur veprime në të gjitha lagjet e qytetit dhe në disa fshatara në Prizren si dhe në qytetet tjera me një numër solid rastesh që kanë gjetur zgjidhje brenda kësaj periudhe. Aktivitetet kryesore që e kanë shoqëruar projektin gjatë vitit kanë qenë: takimet e rregullta në lagje, punëtoritë e vizionimit, performancat publike, hulumtimi, avokimi dhe aktivizmi ndaj autoriteteve publike, zhvillimi dhe konsolidimi i platformës online mahalla.info e cila është shëndërruar në adresë të informacionit mbi gjendjen në lagjet e qytetit dhe fshatra, monitorimi i qeverisë lokale, fushata mediale, dokumentimi dhe ekspozita me konferencën vjetore.

Aktivizimi për të drejtat e njeriut 2020-2023

Projekti ka për qëllim që nëpërmjet shoqërisë civile të përmirësoj të drejtat e njeriut, që janë të natyrshme, origjinale dhe të bazuara në interes të grupit përmes tri komponenteve: 1) Të drejtat e njeriut dhe aktivizimi arsimor; 2) Dokumentimi, monitorimi dhe qasja strategjike dhe 3) Të drejtat mjedisore. Në kuadër të projektit janë realizuar dhe do të realizohen: takime me grupe të ndryshme të komuniteteve dhe përfaqësues të institucioneve, intervenime direkte në hapësira publike për të rritur sasinë e sipërfaqes gjelbëruese, për të krijuar qasje më të lehtë për personat me nevoja të veçanta, trajnime me nxënës dhe studentë, zhvillim të raporteve, hulumtimeve, prodhim të video reportazheve, animacioneve, organizim të debateve/konferencave, performanca publike etj. Projekti realizohet në Prizren dhe Gjakovë por me angazhimin dhe vullnetin e stafit shumë aktivitete janë realizuar edhe në qytete tjera (Dragash, Suharekë, Mamushë, Malishevë, Rahovec, Deçan, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Kamenicë, Kacanik, Viti, Lipjan, Mitrovicë). Projekti do të implementohet edhe gjatë vitit 2022 dhe 2023.

Zbatimi i programeve të strategjisë të EC

Projekti është grant institucional i cili ka për qëllim zbatimin e programeve të EC dhe vazhdimin e përpjekjeve të organizatës për gjithëpërfshirje dhe qëndrueshmëri me fokus te qytetari si garantuesi kryesor i demokracisë dhe zhvillimit. Gjatë periudhës raportuese e deri në përfundim të grantit EC ka vazhduar të zbatojë dhe të realizoj aktivitete që i shërbejnë objektivave strategjike të organizatës. Në kuadër të aktiviteteve të realizuara hyjnë publikimet, takimet, anketat, infografikat, prodhimi i videove të shkurta që trajtojnë tematika dhe probleme të ndryshme, video/reportazhe televizive, artikuj gazetaresk, debate/tryeza diskutimi, reagime/komunikata, monitorim i institucioneve, aksione pastrimi etj. Këto aktivitete jo vetëm kanë sjellë rezultate por kanë shërbyer edhe për promovim dhe nxitje të debatit.

Dollama, një pasuri kulturore e Kosovës 2021-2021

Projekti “Dollama, një pasuri kulturore e Kosovës” është vazhdimësi e përpjekjeve të EC Ma Ndryshe në mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore. Projekti ka për qëllim që të kontribuojë në ruajtjen e zanatit të punimit të dollamave përmes promovimit dhe transferimit të njohurive. Projekti përfshin rajonin e Prizrenit me përfaqësues të të gjitha komuniteteve të këtij rajoni. Pjesëmarrëset nga komuna e Prizrenit, Dragashit, Suharekës (Theranda), Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës do të mësojnë zejen tradicionale të punimit të „dollamave“ nga profesionistë më përvojë të gjërë në këtë fushë. Në kuadër të projektit do të zhvillohet një dokumentar i shkurtë dhe një katalog ku për qëllim është promovimi dhe mbrojtja e veshjeve tradicionale të nusërisë. Në fund të projektit 4 gra/vajza do të mbështeten financiarisht për të hapur biznes privat/individual për qepjen e këtyre veshjeve.

Hulumtimi i Turizmit Rural në Rajonin Jugor të Kosovës 2021-2022

Qëllimi i këtij projekti është të kontribuojë në hartëzimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore përmes dokumentimit, promovimit, transferimit të njohurive dhe aftësive tek të rinjtë dhe komunitetet me përkatësi të ndryshme etnike nga Rajoni Ekonomik Jugor i Kosovës (gjashtë komunat: Prizren, Rahovec, Mamushë, Dragash, Suharekë, Malishevë). Projekti gjithashtu synon të shërbejë në ngritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve vendore dhe qendrore për konceptin “ende të pazhvilluar dhe plotësisht të eksploruar” të turizmit rural si një faktor i qëndrueshëm që ofron edukim dhe zhvillim të qëndrueshëm të komuniteteve lokale. Produkti/aktiviteti kryesor i projektit është zhvillimi i platformës ku do të jenë të paraqitura rreth 200 pika (vende, monumente) të kategorizura si trashëgimi kulturore, natyrore dhe shërbime të cilat kanë potencial për zhvillim të turizmit në rajonin e Prizrenit.

Monitorimi i masave dhe i mbikëqyrjes inspektive të komunave për mbrojtjen e mjedisit 2021-2022

Qëllimi i projektit ka qenë nxitja e diskutimit publik për të shtuar presionin mbi autoritetet publike, sidomos në 7 komunat kryesore (Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjiilan, Ferizaj, Mitrovicë e Jugut dhe Gjakovë), për aplikimin e masave adekuate dhe shtimin e mbikëqyrjes inspektive për mbrojtjen e mjedisit. Në kuadër të projektit janë realizuar video reportazhe, janë publikuar infografika, artikuj gazetaresk, është bërë një hulumtim dhe në fund është organizuar tryezë e diskutimit me përfaqësues të ministrisë, komunës, universitetit, mediave dhe OJQ-ve. Po ashtu është bërë edhe grumbullimi dhe publikimi në forma të ndryshme i të dhënave të nivelit komunal rreth: inspektimit të zbatimit të kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit; monitorimit të gjendjes së deponive të mbeturinave; monitorimit të gjendjes së zonave të mbrojtura; monitorimit të gjendjes së pyjeve, si dhe identifikimit të çrregullimeve mjedisore nga aktivitete të personave fizik ose juridik. Gjithashtu janë grumbulluar dhe publikuar të dhënat për aktvendimet; kërkesat për gjykatë dhe gjobat mandatore të shqiptuara nga niveli komunal. Në fund të projektit është organizuar një tryezë e diskutimit ku është publikuar edhe hulumtimi/raporti me të gjeturat e lartë përmendura.

Rritja e qasjes në drejtësi në nivel komunal

Projekti ka pasur për qëllim të informojë dhe të vetëdijësoj nxënësit dhe studentët nga komunat e Prizrenit, Suharekës dhe Dragashit mbi angazhimin e tyre në sistemin e drejtësisë dhe procedurat vendimmarrëse lokale nëpërmjet, debateve, ligjëratave, trajnimeve dhe duke realizuar simulimin e asambleve komunale. Është organizuar edhe gara për ese me temën “Pse ekziston korrupsioni?” ku në fund janë shpallur fituesit e tre vendeve të para. Është shënuar edhe dita kundër korrupsionit ku janë shfaqur karikaturat e punuara nga Jeton Mikollovci si dhe duke u shpërndarë kartolina me mesazhe sensibilizuese.

Iniciativat tjera:

MODERNe - Iniciativa për Vlerësimin, Mbrojtjen dhe Promovimin e Trashëgimisë Moderne në Kosovë, është nismë me bazë në grup profesionistësh dhe përfaqësues të komunitetit me qëllim të vlerësimit, mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë moderne në qendrat kryesore të Kosovës. Qëllimi i iniciativës është nxitja e debatit publik mbi vlerat e trashëgimisë së shekullit XX dhe zhvillimeve sociale, kulturore e ekonomike që përcollën fillet dhe zhvillimin e arkitekturës dhe artit modern në Kosovë. MODERNe synon që përmes hulumtimit, dokumentimit dhe kultivimit të diskutimit publik mbi vlerat e trashëgimisë moderne të arrijë të kontribuojë në mbrojtjen dhe promovimin kësaj pjese të rëndësishme të trashëgimisë tonë.

Politikat kulturore lokale (RrOK Prizren) - Si pjesë e këtij rrjeti, EC ka vazhduar të angazhohet për zhvillimin e politikave kulturore lokale në Prizren sepse rrjetëzimi lokal i skenës së pavarur kulturore është ndër zhvillimet më të rëndësishme në sektorin e kulturës në Prizren. RrOK-u është formalizuar duke u regjistruar si rrjet i organizatave, është hartuar strategjia dhe plani i punës dy vjeçare dhe pritet që të ketë edhe një person që e luan rolin e drejtorit të rrjetit.

Rrjeti i Organizatave Rinore në Prizren (RrOR) - EC-i është bërë pjesë e këtij rrjeti me qëllim që të kontribuojë duke shpërndarë metodologjinë gjithëpërfshirëse dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjëve në planifikim dhe në vendimmarrje të politikave për zhvillim lokal.

Kino Lumbardhi – Angazhimi i EC për Kino Lumbardhin ka vazhduar edhe gjatë vitit 2021, duke kontribuar në hartimin e planit të menaxhimit të këtij monumenti dhe duke lobuar që si pronë të bartet në pronësi të komunës. Gjatë vitit 2021 është bërë edhe projekti për restaurim të objektit.

Rrjetëzimet - EC ka vazhduar të konsolidojë pozitën e vet brenda rrjeteve nacionale dhe rajonale, ndërsa si pjesë e tyre ka ndihmuar në iniciativat e shoqërisë civile në nivelin qendror, përfshi zbatimin e strategjisë së bashkëpunimit mes qeverisë dhe shoqërisë civile (përmes Civikos), hartimin e strategjive shtetërore të kulturës dhe trashëgimisë kulturore (përmes Forumit Kulturor), vazhdon të jetë pjesë e Forumit Konsultativ për Qeverisje Lokale. Në vitin 2021 EC është njëra ndër themelueset dhe anëtare e bordit të Forumit Lokal të Veprimit për Klimën e cila është një platformë që trajton çështjet e ndryshimeve klimatike dhe mjedisore, në nivel lokal dhe rajonal.

Bashkëorganizimi i aktiviteteve – EC edhe gjatë vitit 2021 ka ndihmuar organizatat e shoqërisë civile nga qytetet tjera për të realizuar aktivitete dhe hulumtime me tema të ndryshme në Prizren. Disa nga organizatat që ka bashkëpunuar në realizim të aktiviteteve janë: CIVIKOS, GAP, FOL, D+, INPO, INDEP, YIHR, etj.

PUBLIKIME

Gjatë vitit 2021, organizata ka realizuar pesëmbëdhjetë publikime (analiza, dokumente të politikave, raporte, studime hulumtuese, vizionime për qytetin, buletinë).

1. NDOTJA E AMBIENTIT NË PRIZREN,
https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/210118195327_Ndotja_e_Ambientit_ne_Prizren_.pdf
2. PUBLIKE DHE MODERNE,
https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/210121141512_PUBLIKE_DHE_MODERNE_EC_20201_.pdf
3. CILËSIA E AJRIT NË PRIZREN,
https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/210318142640_Cilesia_e_ajrit_Prizren_r.pdf

4. MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË KOMUNËN E PRIZRENIT - RAPORT - 2020,
https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/210527102448_Monitorimi_i_Sektorit_te_Mjedisit_ne_Komunen_e_Prizrenitr_.pdf
5. GJENDJA MJEDISORE NË KOMUNËN E GJAKOVËS,
https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/Gjendja_Mjedisore_ne_Komunen_e_Gjakovesr.pdf
6. RAPORT - KARTA E QYTETIT - "E DREJTA MBI QYTETIN E PRIZRENIT",
https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/210723084528_Raporti_KARTA_E_QYTETIT_.pdf
7. HULUMTIM & INFOGRAFIKË - HAPËSIRAT PUBLIKE NË LIPJAN,
https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/210802142727_Hulumtim_infografik_Hap_sirat_publike_n_Lipjan.pdf
8. ECJE NË TRASHËGIMINË MODERNE TË PRISHTINËS,
https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/210809161530_ECJE_NE_TRASHEGIMINE_MODERNE_TE_PRISHTINES_1_.pdf
9. SA JANË QYTETET TONA GJITHPËRFSHIRËSE?,
https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/210908160524_Sa_ian_qytetet_tona_gjithp_rfshir_ser.pdf
10. Turizmi në Prizren,
https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/211221093658_Pyetsori_per_Turizemr.pdf
11. PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE URBAN NË KOMUNAT E KOSOVËS,
https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/211004104739_INFOGRAFIKA_Planifikimi_hap_sinor_dhe_urban_n_komunat_e_Kosov_sr.pdf
12. HAPËSIRAT PUBLIKE GJELBËRUESE NË GJAKOVË,
https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/211204095657_Hapesirat_Publike_Gjelberuese_ne_Gjakove_A4_1_.pdf
13. REFORMA LIGJORE E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR TË KOSOVËS NË QORRSOKAK?!,
https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/211105093559_Reforma_ligjore_e_planifikimit_hapesinor_te_Kosoves_ne_qorrsokakr.pdf
14. KLASA VERORE NË SH.F.M.U "NEZË BUJANI", LIPJAN,
https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/211201124307_KlasaVeroreLipjanr_min.pdf
15. MENAXHIMI I MBETURINAVE NË PRIZREN,
https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/220110145911_Menaxhimi_i_Mbeturinave_A4_.pdf

VIDEO

Gjatë të vitit 2021, organizata ka realizuar tetë video produkte me qëllim për të avokuar dhe ngritur ndërgjegjësimin e opinionit mbi temat e mjedisit, të drejtat e njeriut etj.

1. NDOTJA E AJRIT NGA SHFRYTËZIMI I BIOMASËS PËR NGROHJE

- <https://www.facebook.com/watch/?v=250056059821896>
2. PO NGUFATEMI DHE PO HELMOHEMI NGA NJE VRASËS I PADUKSHËM
<https://www.facebook.com/watch/?v=2886763854904204>
 3. MBETJET INDUSTRIALE
<https://www.facebook.com/watch/?v=439548554044555>
 4. TË DREJTAT E TË RINJVE DHE MUNGESA E QENDRËS RINORE
<https://www.facebook.com/watch/?v=1889638537854606>
 5. DEPONIA E LANDOVICËS ËSHTË NJËRA PREJ 7 DEPONIVE SANITARE TË KOSOVËS
<https://www.facebook.com/watch/?v=299782655267705>
 6. SFIDAT E RI-PYLLËZIMIT TË TOKAVE TË DËMTUARA NGA ZJARRET NË KOMUNËN E SUHAREKËS
<https://www.facebook.com/watch/?v=1175606536294906>
 7. VENDBANIME TË (PA) JETUESHME...
<https://www.facebook.com/watch/?v=1926935507487506>
 8. TEMA E GJITHËPËRFSHIRJES NË SHKOLLA
<https://www.facebook.com/watch/?v=1085742305508467>

DONATORËT

CDF,KCSF,OPIC,KFOS,UNDP,UNHABITAT,MKRS,DKRS,GAP,YIHR,D+

Raporti vjetor i punës për vitin 2021 u miratua në takimin vjetor të Kuvendit të Anëtarëve të EC Ma Ndryshe, mbajtur më 4 Qershor 2022, në Prizren.



Në emër të Kuvendit të Anëtarëve
Flaka Siqeca, kryesuese e Kuvendit të Anëtarëve



Në emër të stafit të organizatës
Valon Xhabali, drejtor ekzekutiv